

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
DREJTORIA RAJONALE OSSH sh.a Kukes

Adresa : Rr. "Islam Spahiu", Prapa Ish Kinemase, Kati II, Kukës

Nr. _____ Prot.

Kukes, më __ / __ /2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion rrjeti TU me kabell ABC Terthore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike **31321000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: 98,619,151 (nentëdhjetë e tete milion e gjashtëqind e nentëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e një) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Ossh sha Kukes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues sipas përcaktimeve të nenit 26, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të dy viteve të fundit (2023 dhe 2024). Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit’’.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit nga data e hapjes së procedurës (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Per piken 2.2.3 është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për çfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohej që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e

shpalljes se njoftimit te kontrates.
Ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, është jo më e vogël se 150% e fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se punimet Jane kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vertetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë për të vertetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Ne rast se punimet Jane kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
 - Fatura Tatimore
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 150% e vlerës së fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përmirësimi i infrastrukturës së linjave TM/TU kërkon një kohë të konsiderueshme për të kryer punët me sukses dhe në përputhje me standardet e nevojshme. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.

Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur.

Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

2.2.3 *Licënsa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

2.3.1 (Kapacitetet teknike dhe profesionale)

a) **Licënsa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontratave**

- | | | |
|---|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria NP-1 • Kategoria NP-11 | <p>Punime germimi në toke,</p> <p>Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)</p> | <p>Klasifikimi A</p> <p>Klasifikimi C</p> |
|---|--|---|

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Shenim: Në rast pjesëmarrjeje të një Operatori ekonomik të huaj, ky i fundit, Licencën e mësipërme me kategoritë e përshkruara, duhet ta ketë të njohur pranë organeve kompetente në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të saj në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehesimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

** Ne rast të bashkimit të operatore ekonomike, Licensat profesionale duhet të paraqese operatori ekonomik që ka marrë persiper punimet për të cilat kerkohet Licensa Profesionale.*

b) Certifikatat që duhet të paraqesin operatori ekonomik:

Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- - ISO 9001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme)
- - ISO 14001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (të vlefshme)
- - ISO 45001: 2018 për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (të vlefshme)

ISO-t e mesipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin persiper.

Shënim: Për certifikatat e mesipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 943, datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në

fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1	Punime germimi e toke)	Germim gropa shtyllash,toke e forte kat IV,~2.5m, sip tab 1.5m	A	0-20 milion leke
N.P-11	(Ndertime per N/stacionet, kab transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Demontim percjelles, demontim paneli, montim paneli, F.V kabell Abc, Zgjidhja e telit TU ne qafat e izolatoreve per nje etj	C	51-100 milion leke

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të Ligjit 162/2020 të Prokurimit Publik, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Konkretisht:

- Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.
- Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, AK duhet të sigurohet se OE zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Paisja me këtë lloj certifikimi dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.
- Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent , pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

c) Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar të paktën 35 persona e vertetuar kjo me:

1. List pagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 10 (dhjete) punonjës elektrikist te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga organe kompetente te akredituara sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar.
2 (dy) prej tyre te jene te pajisur Grupin e IV ose me larte te sigurimit teknik.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ose me kontrate bashkepunimi 3 (tre) manovrator te makinerive te renda te pajisur me deshmite e drejtimit te leshuar nga institucioni perkatese si dhe te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik. Ne rast se OE i ka te punesuar manovratorët duhet te paraqese kontratë pune të vlefshme si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar te pakten 1 (nje) Ing. Ndertimi dhe 1 (nje) Ing. Elektrik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ose me kontrate bashkepunimi 1 (nje) Ing. Topograf për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt. Ne rast se OE e ka te punesuar Ing. Topograf duhet te paraqese kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

dh) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryen punimet ne objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

e) Operatori ekonomik duhet te kete nje person te caktuar te pajisur me certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" sipas parashikimeve nr. 108, date 09.02.2011, i ndryshuar dhe VKM 312 date 05.05.2010.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për çfarë kërkohej më sipër i cili duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Tek Pika c) është kërkuar që ofertusi të ketë të paktën 35 punonjës ku prej tyre 10 duhet të jenë elektrikist për disa arsye: 1) terreni ku do të shtrihet zhvillimi i projektit është terren i theksuar malor, 2) zona ku shtrihet zhvillimi i projektit është zonë me popullsi të dendur, kufizimet e energjisë elektrike nuk mund të jenë me afat kohor të zgjatur, 3) në zonën ku zhvillohet projekti nuk ka mundësi furnizimi me energji elektrike nepermjet një linje alternative për rrjedhojë zona ngelet pa energji elektrike, çfarë na detyron në si autoritet kontraktor që kërkesat ndaj ofertuesve sa i përket numrit të punonjësve, kategorisë së punonjësve të kualifikuar dhe afatit kohor të jenë si më lart, ku elektrikistët kërkohej të ndare sipas kategorive kjo për arsye të punimeve elektrike që janë të nevojshme për tu kryer në objekt, një pjesë e punimeve në objekt si p.sh punimet elektrike në lartësi kërkojnë kategorinë e III ose më lart, një elektrikist me kategorinë e II nuk mund të kryej punime elektrike në lartësi ose shtyllë, kjo bazuar në rregullat e sigurimit teknik. Gjithashtu është e domosdoshme të kryhen manovra me fiderat dhe për rrjedhojë nevojitet që Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre 2 elektrikistë me kategori të IV të sigurimit teknik.

Tek Pika d) kërkohej një Ing Elektrik për arsye të punimeve elektrike që ka objekti dhe për zbatimin e punimeve në objekt si dhe për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik është i domosdoshëm Ing elektrik për të bërë drejtimin e punimeve.

Tek Pika d) kërkohej një Ing Topograf dhe ndertimi për arsye të punimeve ndertimore që ka objekti dhe për zbatimin e punimeve në objekt si piketimi i linjës për vendosjen e shtyllave etj.

Pika c)1 Manovratorët kërkohej për përdorimin e vincave minieskavatoreve për zbatimin e kontratës një vlerë e konsiderueshme e preventivin ka këto karakteristika punimesh.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohej ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.1 (Makineri Pajisje)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Pershkrimi i Automjetit	Sasia
1	Autovinc 8 ton ose me shume	1 copë
2	Ekskavator	2 cope
3	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te percjellesave	1 cope
4	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kablllove	3 cope
5	Pajisje terheqese per percjellesa	1 cope
6	Trailer 25 ton ose me shume	1 cope
7	Betoniere 500 l ose me shume	1 cope
8	Vibrator	1 cope
9	Terraometer per matjen e rezistences se tokezimit	1 cope

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe per mjetet e siguruara me qira, dokumentat qe verteton rregjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit te vlefshme duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese / furnizimit e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi.
- 2- Per paisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimit) te vlefshme.
- 3- Per makinerite me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates shoqeruar me dokumentin qe verteton rregjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin, (te vlefshme).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt shoqeruar me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimit) te vlefshme.
- 5- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 8 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- 6- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- 7-Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për çfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Argumentimi i perlllogaritjes se vleres se fondit limit.

1. Preventivat janë hartuar sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023, botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date 19.04.2023.
2. Paga orare është marre 484.90 leke sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023 629.për zerat jashte liste.
3. Çmimet e bazes materiale janë marre ne baze te manualit te SAP - it, ne OSHEE, studimit te tregut, bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim ose/ cmimet e kontratave te mëparshme, te realizuara.
4. Per punimet e montimit qe nuk janë ne manual i referohemi udhezimit Nr. 2 date 08.05.2003 "Per klasifikimin dhe strukturen e koston se punimeve te ndertimit.
5. Shpenzimet plotesuese janë marre 8 % sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023, botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date 19.04.2023.
6. Norma e fitimit është marre 10 % sipas VKM Nr. 216 date 13.04.2023, botuar ne fletoren zyrtare Nr.66 date 19.04.2023
7. Analizat teknike qe nuk janë ne VKM Nr. 216 date 13.04.2023, janë hartuar si zera jashte liste bazuar ne librin Nr. 6 " Montimi i liniave dhe nënstacioneve " si dhe librin e " Normave komunale".
8. Ne kete preventiv nuk janë llogaritur vlerat per mbikqyrje, kolaudim dhe leje ndertimi.
9. Dherat e germuar largohen plotesisht ne rruge te asfaltuara.
10. Te gjitha proceset e zbatimit te punimeve duhet te kryhen nen mbikqyrjen dhe miratimin e mbikqyresit te punimeve.
11. Te gjitha materialet qe do te përdoren duhet te aprovohen nga mbikqyresi i punimeve para montimit te tyre ne objekt.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

2.3.4 Afati i kryerjes se punimeve është 5 (pese) muaj nga data e dorezimit te sheshit.

Operatori ekonomik duhet te paraqesi grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe është lene ne dispozicion per realizimin e kontrates. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punimeve” Njësia e Prokurimit pasi u konsultua gjerësisht me Degën Teknike për afatin që duhej përcaktuar për kryerjen e punimeve, vëndosi që afati i punimeve të ishte 5 **(pese) muaj**, si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.2 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

– Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i specialisteve të Drejtorisë Qendrore OSHEE sh.a/ OSSH sh.a duke krijuar një unifikim për të gjithë shoqërinë OSHEE sh.a/ OSSH sh.a, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor mbi objektin procedurës së prokurimit, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

1. Në shtojcat përkatëse të specifikimeve teknike ngarkuar në SPE, AK ka kërkuar: “*Certifikatat e fabrikës ISO 9001*”.

Kjo certificate kerkohet ne momentin e levrimit te mallit nga operatori ekonomik fitues dhe shoqeron mallin qe instalohet ne objekt. Kurse ne momentin e ofertimit.AK pranon mundësinë të një vetëdeklarimi

nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit

2. Në Shtojcën specifikimet teknike ku AK ka kërkuar të paraqesin *“Te gjithë test raportet e fabrikes”*.

Ne rastet kur është kërkuar *“Te gjithë test raportet e fabrikes”* sipas specifikimeve teknike, këto teste janë përcaktuar në materialin *“Specifikimet teknike”* në paragrafet *“Standartet referuese”* dhe *“TESTET”*

3. Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve europiane: **“IEC 60439-1, IEC 60 947-2, IEC 898, IEC 947-1, ...etj”**, por **do të pranojë dhe ekuivalentet e tyre sipas legjislacionit në fuqi.**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

Njesia e Prokurimit

Arrian Gjani

Arjet Bogdani

Gazmir Qerimi